



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_. 03. 2010

**V E N D I M**  
**Nr.1183, datë 10.03. 2010**

**Për**  
**“Miratimin e aktit normativ “Udhëzues për procedurat e këshillimit me publikun”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e dates 10.03. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, me objekt:

**“Miratimi i aktit normativ “Udhëzues për procedurat e këshillimit me publikun”**, mori në shqyrtim materialet shkresore të paraqitura nga Drejtoria Juridike të përbëra nga:

- Udhëzues “Për procedurat e këshillimit me publikun” (**Projektakti**);
- Relacioni shpjegues mbi projektaktin (**Relacioni**);
- Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485 (**Projektvendimi**).

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronja p) e nenit 8, neni 110 dhe pika 1 e nenit 115, të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

## V Ë R E H E T se :

1. Projektakti nxirret nga AKEP në zbatim të kompetencës të përcaktuar në shkronjën p) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor me aktet e nevojshme nënligjore, lidhur me procedurën për kryerjen e këshillimit me publikun sipas nenit 110 të këtij ligji.
2. Projektakti është hartuar nga Drejtoria Juridike në bashkëpunim me konsulentin “Development Dynamics” L.td. në kuadër të projektit “EBRD/EU Communications Regulatory Development Project”.
3. Me Vendim të Këshillit Drejtues, Nr. 940, datë 17.08.2008 “Për miratimin për konsultim publik të projektaktit normativ “Udhëzues për procedurat e këshillimit me publikun”, projektakti u hodh për këshillim publik, në përfundim të të cilit rezultoi se nuk janë paraqitur komente nga palët e interesuara.
4. Përmbajtja e projektaktit është në përputhje me parimet dhe procedurat administrative të parashikuara në ligjin nr. 8485, si dhe përcaktimet ligjore të parashikuara në nenin 110 të ligjit nr. 9918.

## ATEHERE:

Për sa më sipër, duke patur parasysh se projektakti përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në bazën ligjore referuese, si dhe përbën një akt nënligjor të rëndësishëm për kryerjen e procedurave për këshillimin me publikun, KD i AKEP bazuar në pikën 1 të nenin 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

## V E N D O S I :

1. Të miratojë aktin normativ Udhëzues “Për procedurat e këshillimit me publikun” sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Akti i miratuar të publikohet në faqen e internetit [www.akep.gov.al](http://www.akep.gov.al)

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

## A N E T A R E T:

1. **Alketa Mukavelati** \_\_\_\_\_
2. **Benon Paloka** \_\_\_\_\_
3. **Ibsen Elezi** \_\_\_\_\_
4. **Zamira Nurce** \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

---

**UDHËZUES PËR PROÇEDURAT E KËSHILLIMIT ME  
PUBLIKUN**

*Miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP Nr. 1183, datë 10.03. 2010.*

## Udhëzues për Proçeurat e Këshillimit me Publikun

### Përmbajtja

### Faqe

1. Hyrje dhe Qëllimi i Këtij Dokumenti .....	5
2. Parimet e Këshillimit.....	7
3. Proçedurat e Këshillimit .....	9

## 1. HYRJE DHE QËLLIMI I KËTIJ DOKUMENTI

- 1.1 Transparenca në zhvillimin e politikave dhe rregulloreve të reja është një përjasje praktike dhe me kosto të ulët në reduktimin e rreziqeve rregullatore dhe ruajtjes së pavarësisë së rregullatorit. Në kuadër të rregullimit të telekomunikacioneve, transparenca i referohet një procesi të hapur të ushtrimit të fuqive rregullatore, të cilat, sigurojnë paanësi, përgjegjësi dhe besueshmëri të rezultateve. Procedurat transparente e lejojnë rregullatorin të:
- Reduktojë asimetritë e informacionit;
  - Të vërtetojë pavarësinë dhe në këtë mënyrë të rrisë besimin e publikut dhe industrisë në procesin rregullator;
  - Të rrisë besueshmërinë me një kosto të ulët dhe në këtë mënyrë të tërheqë investimet;
  - Të vlerësojë ndikimin e rregulloreve të reja;
  - Të frenojë tërheqjen rregullatore, që do të thotë të parandalojë shndërrimin në një rregullator të influencuar nga politika ose nga interesat e pronarëve.
- 1.2 Një praktikë e mirë, përdorur nga rregullatorët modernë është mbajtja e këshillimeve publike para marrjes së vendimeve rregullatore. Këshillimi publik është një marrëdhënie dypalëshe në të cilën qytetarët dhe kompanitë paraqesin vlerësimet e tyre lidhur me çështjet e përcaktuara nga rregullatori. Këshillimi duhet të jetë i hapur për të gjitha grupet e shoqërisë tek të cilat vendimi rregullator mund të ketë ndikim. Duhet të përdoret për të mbledhur informacion lidhur me nevojën e marrjes së një vendimi rregullator ose jo dhe lidhur me mënyrën në të cilën mund të hartohet sundimi i ligjit në mënyrë që të arrihet qëllimi i tij me një kosto sa më të ulët për bizneset.
- 1.3 Sipas nenit 110 të Ligjit për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është i detyruar të sigurojë dhe mbajë shënimet e duhura të interesave të palëve të interesuara para marrjes së vendimeve të cilat do të influencenin ndjeshëm tregun. Ligji më tutje thekson se AKEP-i do të publikojë dokumentet e propozuara rregullatore dhe do të kërkojë duke lejuar jo më pak se 30 ditë për palët me interes që t'i paraqesin komentet me shkrim. AKEP-i gjithashtu mund të organizojë dëgjim publik në të cilin përfaqësuesit e palëve të interesuara mund të ftohen për të paraqitur mendimet e tyre lidhur me dokumentet e propozuara rregullatore. Pas periudhës së caktuar për paraqitjen e komenteve me shkrim dhe para miratimit të rregullores, AKEP-i do të publikojë këto komente duke ruajtur fshehtësinë e informacioneve sensitive. Nenet e tjera të ligjit gjithashtu i vendosin kërkesë AKEP-it për të organizuar këshillime publike, për shembull në rastin e analizës së tregut ku periudha e përcaktuar për paraqitjen e komenteve është 60 ditë.
- 1.4 Sipas akteve të BE-së, është edhe një kërkesë specifike për mbajtjen e këshillimeve publike si pjesë e Direktivës Kuadër. Neni 6 i Direktivës kërkon që Autoriteti Rregullator Kombëtar (ARK) të publikojë procedurat për këshillim dhe gjithashtu kërkon që kur ARK ka për qëllim të

marrë masa të cilat do të kenë ndikim të ndjeshëm në tregun përkatës, palëve të interesuara do të ju jepet mundësia për të komentuar<sup>1</sup>.

### **Qëllimi i këtij dokumenti**

- 1.5 Ky dokument vendos udhëzimet për mbajtjen e këshillimeve publike nga AKEP-i për çështje brenda fushave të kompetencës së AKEP-it. Kjo do të arrihet kryesisht nepërmjet procedurave të cilat lejojnë që këndvështrimet e palëve të interesuara të merren parasysh gjatë konsiderimit të masave rregulluese të këtij sektori.
- 1.6 Ky udhëzues për procedurat e këshillimit është informacion për palët të cilat dëshirojnë që opinionet e tyre të konsiderohen si pjesë e procesit të këshillimit dhe vazhdimisht do t'ju dergohet informacion i përditësuar.

---

<sup>1</sup> Council Directive 2002/21/EC on a common regulatory framework for electronic communications networks and services (Framework Directive), Art. 6, 7 March 2002. Exceptions to the public consultation requirement include: (a) exceptional circumstances where there is an urgent need to act, (b) dispute resolution between undertakings, and (c) resolution of cross-border disputes.

## 2. PARIMET E KËSHILLIMIT

- 2.1 Ligji për Komunikimet Elektronike dhe Postare kërkon nga AKEP-i të sigurojë dhe të marrë parasysh mendimet e palëve të interesuara para marrjes së vendimeve të cilat do të ndikojnë ndjeshëm në treg. Prandaj janë dy elemente kryesore të cilat duhet të konsiderohen lidhur me procedurat për këshillim, ato janë – kush janë palët me interes dhe çfarë duhe konsideruar e rëndësishme.

### **Kush janë palët me interes?**

- 2.2 AKEP-i konsideron se të gjitha palët duhet të kenë të drejtën të bëjnë komente në projekt-masat rregullatore dhe prandaj propozon të ftojë për të bërë komente të gjitha palët të cilat kanë interes në çështjen e konsideruar. Prandaj, AKEP do të aplikojë parimin që çdo palë është e lirë të bëjë komente për të gjithë projekt-masat rregullatore.

### **Si vlerësohet një ndikim i ndjeshëm?**

- 2.3 Se çfarë përbën një ndikim të ndjeshëm nuk mund të përcaktohet saktësisht dhe në shumë situata do të kërkojë një shkallë të vlerësimit subjektiv nga rasti në rast. Aktet e BE-së vendosin fusha të caktuara ku këshillimi është i detyruar dhe AKEP-i do të konsiderojë këto fusha kur vendos lidhur me nevojën për këshillim. Këto fusha përfshijnë:

- Vendosja e telefonave publikë me pagesë
- Objektivat cilësore të detyrimit për Shërbim Universal
- Kërkesat për publikimin e informacionit të krahasueshëm për cilësinë e shërbimit
- Kufizimi i numrit të të drejtave të përdorimit për radio frekuenca
- Amendimi i të drejtave, kushteve dhe procedurave lidhur me autorizimet e përgjithshme dhe të drejtat e përdorimit
- Vendosja e detyrimeve për akses dhe interkoneksion ndaj operatorëve me FNT

- 2.4 Përveç ku përcaktohet nga ligji, çështjet për këshillim do të vendosen rast pas rasti duke marrë parasysh faktorët siç janë ndikimi i mundshëm në treg ose tek konsumatorët, numri i palëve potencialisht të ndikuara, nëse pikat e parimeve janë të përfshira dhe impakti i mundshëm i rregullimit në koston e përdoruesve dhe/ose operatorëve dhe marrja parasysh e udhëzimeve të BE-së në këtë fushë.

### **Këshillimi me shkrim**

- 2.5 Për çështje të rëndësishme (shih më sipër) AKEP-i do të mbajë këshillime publike në bazë të dokumenteve me shkrim për këshillim para zbatimit të masave të caktuara rregullatore. Dokumentet për këshillim do të përcaktojnë masat e parashikuara dhe argumentojnë faktorët të cilët AKEP-i konsideron me rëndësi për çështjen. Mund të oranzohet bisedime paraprake me grupet dhe përfaqësuesit e grupeve ose shoqatave para këshillimit formal. Këto diskutime nuk janë zëvendësim për këshillime më të gjëra, por mund të përdoren nga AKEP-i për të informuar lidhur me procesin e hartimit të një projekt mase rregullatore.

- 2.6 Dokumentet për këshillim do të përmbajnë një përshkrim të qëllimit të këshillimit dhe përmbajtjen e vendimit të propozuar ose përshkrim të temave dhe çështjeve të trajtuara. Do të vendoset afati kohor për këshillimin dhe afati për paraqitjen e komenteve dhe gjithashtu një emër i personit të kontaktit dhe detajet se si dhe ku mund të paraqiten komentet. Këshillimi gjithashtu do të referohet autoritetit nën të cilin çështja e nxjerrë për këshillim është propozuar, informacion për hapat e ardhshëm të rregullatorit pas përfundimit të këshillimit, dhe nëse kërkohet, ku dhe si mund të merret informacion i mëtejshëm.
- 2.7 Gjithashtu, AKEP-i do të ftojë paraqitjen e komenteve në bazë të dokumentit të përgjithshëm për diskutim dhe jo në bazë të projekt masave specifike rregullatore. Kjo do të paraprinte një këshillimi të projekt masave specifike rregullatore.
- Të gjitha këshillimet aktuale do të jenë të disponueshme nëpërmjet web faqes së AKEP-it.
  - Njoftimet me email gjithashtu do të dërgohen palëve të cilat regjistrohen në AKEP për të marrë njoftime lidhur me publikimet e reja
  - Kopjet (hard copy) e të gjitha dokumenteve për këshillim do të jenë të disponueshme sipas kërkesës.
  - Një njoftim do të vendoset në buletin për të njoftuar disponueshmërinë e dokumentit dhe afatin e fundit për paraqitjen e komenteve.
  - Kur vlerësohet e nevojshme, njoftimet gjithashtu mund të vendosen në [gazeta].
  - Masa rregullatore të nevojshme do të merren për të monitoruar informacionin sensitive (udhëzime të mëtejshme do të nxirren për mbrojtjen e informacionit konfidencial).

### **Këshillimi jo-formal**

- 2.8 Kur një çështje nuk konsiderohet e rëndësishme, AKEP-i mund të mbajë një proces më pak formal për këshillim, duke përfshirë studim dhe analizë për të kuptuar këndvështrimet, nevojat dhe sjelljen e njerëzve dhe organizatave të përfshira ose të cilat kanë interes në këtë sektor. Kjo mund të bëhet nëpërmjet një studimi ose mbledhjeve me industrinë, individët dhe grupet, si dhe konsumatorët dhe organet e konsumatorëve.



#### **Kohëzgjatja e këshillimit**

- 3.1 Kohëzgjatja minimale e lejuar për përgjigje e vendosur me ligj është 30 ditë. AKEP-i ka kompetenca ta zgjasë këtë afat kohor. Në raste kur gjatë periudhës së këshillimit ka festë kombëtare, mund të lejohet kohë shtesë për marrjen e komenteve. Në situata të jashtëzakonshme, AKEP-i gjithashtu mund të konsiderojë zgjatjen e periudhës së këshillimit nëse kërkohet nga personat që do të japin komente.
- 3.2 AKEP-i do të konsiderojë këto kërkesa nëse pranohen brenda 5 ditëve të punës nga data e publikimit. Kjo është e nevojshme për të lejuar kohë të mjaftueshme për të mundësuar shqyrtimin e duhur të arsyeve të kërkesës dhe gjithashtu për të informuar palët e tjera lidhur me zgjatjen e afateve kohore nëse kjo miratohet.

#### **Dëgjimi Publik**

- 3.3 Dëgjimi publik ofron një mundësi formale për individët dhe palët me interes të dëgjohej në një mbledhje të planifikuar dhe të hapur të organizuar nga rregullatori para marrjes së vendimit lidhur me miratimin e rregullave të propozuara. Sipas Ligjit për Komunikacionet, AKEP-i mund të organizojë një mbledhje publike nëse e sheh të arsyeshme. Para mbajtjes së dëgjimit publik, AKEP-i do të publikojë detajet e kësaj mbledhjeje në web-faqe, nëpërmjet një njoftimi në buletin ose nëpërmjet publikimit në një nga gazetatat. Seancat e një mbledhjeje të tillë publike do të regjistrohen dhe zbardhen në mënyrë që të jenë publikisht të disponueshme. AKEP-i do të vendosë procedurat të cilat do të zbatohen gjatë mbledhjeve të tilla duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e mbledhjeve, kërkesën për regjistrim të pjesëmarrësve para mbledhjes dhe rolin e kryetarit të mbledhjes.

#### **Paraqitja e komenteve**

- 3.4 Vetëm komentet me shkrim do të mirëprehen nga cilado palë me interes. Përveç nëse pranohen si pjesë e procesit të këshillimit publik, komentet e tjera nuk do të merren parasysh.
- 3.5 Çdo dokument për këshillim do të përmbajë udhëzimet lidhur me mënyrën e paraqitjes së komenteve në AKEP. Komentet duhet, nëse është e mundur, të paraqiten në formë elektronike por komentet e dërguara me postë, faks ose komentet e dorëzuara personalisht gjithashtu do të pranohen nëse paraqiten para përfundimit të periudhës së këshillimit. Pasi që është pjesë e politikës së AKEP-it të bëjë të disponueshme për inspektim të gjitha përgjigjet, do të kërkohet nga dërguesit e përgjigjeve që materialin konfidencial ta vendosin në një shtojcë të veçantë.
- 3.6 AKEP-i nuk propozon të vërtetojë pranimin e përgjigjeve.
- 3.7 Trajtimi i materialit konfidencial do të jetë subjekt i një udhëzuesi të veçantë që do të ofrohet më vonë.

#### **Marrja parasysh e Komenteve**

- 3.8 AKEP-i do të marrë parasysh mendimet e palëve me interes në kuadër të marrjes së vendimit në çështje të veçanta. Të gjitha mendimet do të merren parasysh në bazë të vlerave të mendimeve të shprehura. Duhet të theksohet se këshillimi nuk është një votim as dhe një praktikë e ndërtimit të një marrëveshjeje – palët me interes mund të paraqesin informacion nëpërmjet këshillimit por vendimi se si do të vazhdohet gjithmonë është kompetencë e AKEP-it, i cili mund të mos pajtohet me mendimet e paraqitura.
- 3.9 Nuk është praktike për AKEP-in të bëjë komente për secilin koment të paraqitur por raporti mbi këshillimin do të përmbledhë elementet kryesore të komenteve të paraqitura dhe qëndrimet e AKEP-it lidhur me këtë.

### **Veprimet e ndërmarra pas këshillimit**

- 3.10 AKEP-i do të publikojë në web-faqe një raport mbi të gjitha këshillimet, i cili do të ofrojë një pasqyrë të komenteve të pranuar, përgjigjes së AKEP-it si dhe vendimit të AKEP-it lidhur me çështjen e nxjerrë për këshillim.
- 3.11 AKEP-i beson se transparencja e procesit kërkon që mendimet e shprehura nga palët duhet të jenë të disponueshme publikisht. Të gjitha përgjigjet e pranuar do të bëhen të disponueshme për inspektim përveç materialit konfidencial (të shënuar si konfidencial). Kur palët me interes telefonojnë zyrat e AKEP-it për tu vënë në dijeni lidhur me përgjigjet, AKEP-i do të organizojë dërgimin e materialit. Megjithatë, nëse këto marrëveshje krijojnë kosto domethënëse, kopjimi, postimi, etj., mënyra e dërgimit të materialit do të rishikohet.